



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 451 prot

Maliq më 29.01.2019

VENDIM

Nr. 21 , datë 28.01.2019

Për

“Themelimin e shoqërisë “Klubi i Futbollit Maliq” sh.a dhe miratimin e aktit të themelimit”

Ligjit 139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore”, neni 54, gërma (d), ligjit .9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, nenit 135 i ndryshuar Këshilli i Bashkisë në cilësinë e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve

VENDOSI:

1. Të themelojë shoqërinë tregëtare “Klubi i Futbollit Maliq” sh.a.
2. Të miratojë aktin e themelimit të shoqërisë sipas tekstit bashkëngjitur.
3. Aksionari i vetëm i shoqërisë dhe zotërues i 100% të aksioneve është Bashkia Maliq.
4. Për zbatimin e këtij vendimi dhe regjistrimin e tij pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit ngarkohen organet drejtuese të shoqërisë, Këshilli Mbikqyrës dhe Administratori/ët.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

NËN/ KRYETARI I KËSHILLIT

ALEKSANDRA SPAHO



AKT-THEMELIMI

(Për krijimin e shoqërisë tregtare "Klubi i Futbollit Maliq" sh.a)

Bashkia Maliq, njësi e vetëqeverisjes vendore, me seli në Maliq, adresa : Rruga Bulevardi "**Rinia**" Maliq, ligjërisht e përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë, Z.Gëzim Topçiu , shtetas shqiptar me datëlindje 03.01.1967 lindur në Trebickë , Korçë, posedues i letërnjoftimit shqiptar me nr. G70103172K madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Subjekti i mësipërm,

Në mbështetje të Ligjit nr. 9901, dt.14.04.2008 "*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*", i ndryshuar, Ligjit nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 "*Për Qendrën Kombëtare të Biznesit*", i ndryshuar, me vullnetin e saj të lirë,

VENDOSI:

Të themelojë shoqërinë "Klubi i Futbollit Maliq" sh.a.

Bazuar në legjislaconin shqiptar përkatës në fuqi, subjekti themelues i "*Klubi i Futbollit Maliq*" sh.a më kërkoi të hartoj këtë akt themelimi, i cili sanksionon krijimin e shoqërisë dhe përcakton në mënyrë të përgjithshme ndarjen e raportit të pjesëmarrjes në kapitalin e shoqërisë, organet dhe kompetencat e tyre dhe çështje të tjera si më poshtë vijon:

Neni 1

Forma juridike, Kohëzgjatja dhe Selia

1. "*Klubi i Futbollit Maliq*" sh.a është shoqëri aksionare , me ofertë private.
2. "*Klubi i Futbollit Maliq*" sh.a krijohet për një kohëzgjatje të përcaktuar.
3. Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria kundrejt të tretëve apo në aktet e brendshme do të shënohet emërtimi "*Klubi i Futbollit Maliq*" sh.a.
4. Selia e shoqërisë "*Klubi i Futbollit Maliq*" sh.a ndodhet në Blloku nr.1 , Maliq.

Neni 2

Qëllimi i shoqërisë

"*Klubi i Futbollit Maliq*" sh.a është një shoqëri tregtare , me qëllim fitimi, e cila synon të zhvillojë aktivitetet në Republikën e Shqipërisë ose jashtë Kufijve të Republikës së Shqipërisë.

Neni 3

Objekti

Shoqëria aksionare do të kryejë kryesisht aktivitetin e mëposhtëm:

1. Projektimin, financimin, zhvillimin dhe menaxhimin e projekteve të sportit të të gjitha llojeve me qëllim nxitjen dhe masivizimin e sportit , krijimin e akademive sportive dhe ekipeve zinxhir.
2. Dhënia në përdorim të tretëve, ruajtjen, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e objekteve që shoqëria ka në administrim.

3. Çdo aktivitet tjetër në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni 4

Kapitali themeltar

- a) Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë në vlerën **3.500.000** (*tre milion e pesëqind mijë*) **lekë**, i ndarë në **350** (*treqind e pesëdhjetë*) aksione të zakonshme me vlerë nominale **10 000** (*dhjetë mijë*) Lekë secili.
- b) Aksionari i vetëm i "*Klubi i Futbollit Maliq*" sh.a është Bashkia Maliq duke zotëruar 100% të aksioneve.
- c) Numri i përgjithshëm i aksioneve do të jetë: 350 (*treqind e pesëdhjetë*); kapitali i regjistruar: **3.500.000** (*tre milion e pesëqind mijë*) **lekë**;

Neni 5

Organet e shoqërisë

Organet e shoqërisë aksionere janë:

- 1. Asambleja e Përgjithshme;
- 2. Këshilli mbikqyrës ;
- 3. Administratori/administratorët.

Neni 6

Asambleja e Përgjithshme

- 1. Asambleja e Përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtëme të shoqërisë:
 - a) Përcaktimin e politikave tregëtare;
 - b) Ndryshimet e statutit;
 - c) Emërtimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar
 - d) Miratimin e skemës së shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjën "c" të kësaj pikë;
 - e) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - f) Shpërndarjen e fitimeve vjetore;
 - g) Zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;
 - h) Pjesëtimin e aksioneve dhe anulimin e tyre;
 - i) Ndryshime në të drejtat, që lidhen me aksione të llojeve e kategorive të veçanta;
 - j) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykimet ndaj organeve të administrimit;
 - k) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - l) Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të saj;
 - m) Çështje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ligji apo statute.
- 2. Asambleja e Përgjithshme merr vendime pas shqyrtimit të dokumentave përkatëse, së bashku me raportin e Këshillit të Administrimit dhe raportin e ekspertit kontabël të autorizuar.
- 3. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme që kanë lidhje me çështjet e përcaktuara në pikën 1 gërmat h) dhe k) të merren me unanimitet.
- 4. Vendimet e Asamblesë të cilat kanë efekt mbi buxhetin e aksionarit Bashkia Maliq janë të vlefshme vetëm me miratimin nga ana e këtij aksionari sipas ligjit;

Neni 7
Këshilli i Mbikqyrës

1. Këshilli i Mbikqyrës përbëhet nga tre persona fizikë si anëtarë të tij. Emërtimet do të jenë individuale . Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës emërtohen dhe shkarkohen nga detyra në çdo kohë nga Kryetari i Bashkisë.
2. Shpërblimi mujor për Këshillin Mbikqyrës të jetë sipas akteve ligjore në fuqi.
3. Mandati i Anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës është 3 (tre) vjeçar.
4. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës janë të pavarur dhe nuk do të jenë Administratorë.
5. Këshilli Mbikqyrës ka këto të drejta dhe përgjegjësi:
 - a) të kontrollojë e të mbikqyrë zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë nga administratorët;
 - b) të përgatisë, me kërkesë të asamblesë së përgjithshme, marrjen e masave, që janë në kompetencë të kësaj të fundit, t'i rekomandojë asaj vendime të nevojshme për t'u marrë, si dhe të zbatojë vendimet e asamblesë;
 - c) të thërrasë mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, sa herë vlerësohet e nevojshme për interesat e shoqërisë;
 - d) të kujdeset që shoqëria të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit;
 - e) të shqyrtojë e të kontrollojë librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e shoqërisë;
 - f) të sigurojë se pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo statutit, të kryhen me saktësi nga administratorët. Këto dokumente duhet të miratohen e të nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e këshillit mbikqyrës për t'iu paraqitur asamblesë së përgjithshme, së bashku me një raport të këshillit mbikqyrës për miratimin dhe një përshkrim për mbikqyrjen e menaxhimit gjatë gjithë vitit financiar;
 - g) të sigurojë se auditimi i librave dhe i regjistrimeve kontabël të kryhen të paktën një herë në vit nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur e raporti i auditimit, drejtuar asamblesë së përgjithshme, t'u vihet në dispozicion të gjithë anëtarëve të këshillit e administratorëve. Raporti i këshillit mbikqyrës, duhet të përmbajë edhe mendimin për raportin e auditimit;
 - h) të emetojë dhe të shkarkojë administratorët, të ndajë kompetencat ndërmjet tyre;
 - i) të përcaktojë shpërblimin e administratorëve;
 - j) të miratojë marrjen përsipër të detyrimeve me vlerë më të lartë se 5% të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare, të certifikuara, nëpërmjet nënshkrimit të huave apo emetimit të obligacioneve apo instrumenteve të tjera të borxhit;
 - k) të vendosë krijimin e bashkëpunimeve tregtare afatgjata dhe propozimin e politikave, për themelimin e shoqërive tregtare ose të grupeve të reja;

Neni 8
Administratorët

1. Administratori/administratorët emërtohen në detyrë nga Këshilli Mbikqyrës për një periudhë 3(tre) vjeçare. Emërtimet do të jenë individuale. Administratorët mund të shkarkohen në çdo kohë nga detyra, pa cënuar të drejtat që burojnë nga një kontratë pune e lidhur me shoqërinë.

2. Politikat tregtare të shoqërisë do të administrohen dhe shoqëria do të përfaqësohet nga Administratorët të cilët mund të ushtrojnë të gjitha kompetencat e tyre në përputhje me parashikimet e statutit.
3. Administratori/ët kanë këto të drejta dhe detyrime:
 - a) të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë;
 - b) të përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
 - c) të kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentave dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - d) të përgatisin dhe të nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, të cilët ia paraqesin këshillit mbikqyrës për miratim, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, për t'u paraqitur më pas për miratim nga asambleja e përgjithshme;
 - e) të krijojë një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat, që kërcënojnë ekzistencën e shoqërisë;
 - f) të kryejë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të shoqërisë, sipas parashikimeve të këtij ligji apo të ligjeve të tjera;
 - g) të raportojnë përpara këshillit të administrimit për zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimtarive me rëndësi të veçantë, për veprimtarinë e shoqërisë;

Neni 9

Mbulimi i humbjeve

1. Humbjet e mundshme të krijuara nga aktiviteti tregtar i shoqërisë përgjatë një viti ushtrimor ose të mbartura, do të mbulohen nga aksionarët në përputhje me raportin e pjesëmarrjes në kapitalin themeltar.
2. Mbulimi i humbjeve nga ana e aksionarëve mund të kryhet përmes zmadhimit ose zvogëlimit të kapitalit themeltar, emetimit të obligacioneve ose titujve të ndryshëm, ose në çdo formë tjetër të njohur me ligj.

Neni 10

Te tjera

1. Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë aksionare do të bëhet në përputhje me dispozitat e parashikuara nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe nga Statuti i "Klubi i Futbollit Maliq" sh.a.
2. Aksionarët e shoqërisë mund të vendosin për pjesëmarrjen e shoqërisë në aktivitete të tjera tregtare, ndarjen, tjetërsimin apo prishjen e shoqërisë.

Ky akt-themelimi hartohet në katër kopje të njëjta në gjuhën shqipe.

Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve

AKSIONARËT:

BASHKIA MALIQ

Ligjërisht e përfaqësuar nga Kryetari:

Z. Gëzim TOPÇIU

(Emër, Mbiemër, Firmë, Vullë)



28-01-2019-